

PIKËPAMJET E PROFESOR REXHEP QOSJES MBI IDENTITETIN SHQIPTAR

Rovena VATA MIKELI¹, Arburim ISENI²

¹ Akademia e shkencave e Shqipërisë, Institutet e Albanologjisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Departamenti i Studimeve Letrare
Tiranë, Shqipëri

² Fakulteti i Filologjisë, Programi studimor i gjuhës dhe letërsisë angleze, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Tetovë, Maqedonia e Veriut
E-mail: rovena_vata@hotmail.com, arburim.iseni@unite.edu.mk

Abstract

Academician Rexhep Qosja is without a doubt an icon of the development of literature, the history of literature, Albanian culture, and, most importantly, his ideas, thoughts, opinions, and advice as an intellectual, researcher, and citizen on the developments of yesterday's politics and the changes in today's politics. A significant portion of his writings address issues of Albanian identity. The main concepts established by researcher R. Qosja regarding the issue of Albanian identity are based on common ancestry, which includes elements such as culture, language, value system, and common history.

According to academic Rexhep Qosja, these are the essential elements that form the national identity of Albanians. He further asserts that all identities—individual, collective, cultural, religious, or political—can be integrated into a singular entity known as national identity; thus, religious identity constitutes a component of national identity. R. Qosja discusses an Albanian identity that is both occidental and oriental, referring to it as our dynamic identity, while insisting that we do not conceal our authentic "Muslimism."

Professor R. Qosja posited that we possess a distinct identity and a universal identity, individual identities and collective identities, traditional identity and contemporary identity, historical identities and cultural identities, political identities and cognitive identities, religious identity and global identity. All these identities, which are relatively specific and narrower in scope, coalesce into a singular entity that we shall refer to as "national identity".

Keywords: Identity, nation, culture, language, value system, religious consciousness, religious civilizations.

Abstrakt

Akademik Rexhep Qosja është padyshim ikonë e zhvillimit të letërsisë, e historisë së letërsisë, e kulturës shqiptare dhe mbi të gjitha e ideve, mendimeve, opinioneve e këshillave të tij, si intelektual, studiues, qytetar për zhvillimet e politikës së djeshme dhe ndryshimet në politikën e sotme. Një pjesë e mirë e shkrimeve të tij, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjet e identitetit shqiptar. Konceptet kryesore që themelon studiuesi R. Qosja rreth çështjes së identitetit shqiptar, kanë të bëjnë me prejardhjen e përbashkët, ku brenda kësaj prejardhje të përbashkët, ai përfshin elementin e kulturës, gjuhës, sistemin e vlerave dhe historinë e përbashkët. Këto janë faktorët themelorë të cilët përbëjnë identitetin kombëtar të shqiptarëve, sipas mendimit të akademik Rexhep Qosjes. Ai shton më tej në mendimin e tij lidhur me këtë çështje se të gjitha identitetet, qofshin ato individuale, kolektive, kulturore, fetare apo politike, mund të bashkohen në një të tërë, i quajtur identiteti kombëtar, d.m.th, identiteti fetar është element, pjesë e identitetit kombëtar. Gjithashtu R. Qosja flet për një identitet shqiptar, që është sa oksidental, po aq edhe oriental, e quan identitetin tonë dinamik, teksa kërkon që mos ta fshehim "myslimanizmin" tonë real.

Profesor R. Qosja ishte i mendimit se kemi identitet të veçantë dhe identitet të përgjithshëm, identitete vetjake dhe identitete kolektive, identitet konvencional dhe identitet të ri, identitete historike dhe identitete kulturore, identitete politike dhe identitete mendore, identitet fetar dhe identitet shtetëror. Të gjitha këto identitete që janë identitete më pak a më shumë të veçanta, të një rrafshi më të ngushtë, bashkohen në një të tërë, që do t'i themi "identitet kombëtar".

Fjalë kyçe: Identitet, komb, kulturë, gjuhë, sistem i vlerave, vetëdije fetare, qytetërime fetare

Hyrje

Në vështrimin e përgjithshëm, me “identitet” nënkuptojmë “veçantinë apo tiparet që ka një send, të cilat nuk ndeshen bashkërisht në sendet e tjera”. Në gjirin e shoqërisë njerëzore çdo hallkë e saj ka identitetin e vet, i cili mund të jetë fizik, moral, kulturor, juridik e politik.

Kështu për shembull, njeriu, qenia bazë e shoqërisë njerëzore, burrë ose grua qoftë, ka si tipar themelor identitetin fizik, në vështrimin antropologjik, pra veçori thjesht personale që nuk ndeshen të gjitha së bashku tek qeniet e tjera si: emri, mbiemri, vendlindja, datëlindja, atësia, amësia, seksi, lartësia trupore, ngjyra e lëkurës, e flokëve, e syve, difektet fizike dhe shenjat e gishtërinjëve ose shenjat biometrike.

Në të njëjtën kohë, po ajo qenie njerëzore, ka edhe identitetin e vet kulturor e qytetar, me të cilin nënkuptohen: gjuha amtare, arsimi i kryer, përkatësia etnike, qytetaria (shtetërore), në disa raste, por jo kurdoherë, edhe përkatësia fetare, të cilat, edhe pse janë përkatësi personale, nuk hyjnë në qerthullin e identitetit të mirëfilltë, pasi ndeshen edhe në qenie të tjera humane.

Në hallkat e tjera të shoqërisë njerëzore siç janë: bashkësia familjare, fshatare, qytetare, krahinore, kombëtare, identiteti fizik vijnë duke u zbehur, kurse në plan të parë spikatin identitetet kulturore dhe ato qytetare.

Megjithatë, ka raste kur përkatësia fetare është përfshirë në identitetin familjar, fshatar, qytetar, krahinor, kombëtar, si për shembull: te polakët (të gjithë katolikët), ose te grekët (të gjithë ortodoksë), ose te turqit (të gjithë myslimanë).

Por në raste kur përkatësia fetare nuk përfshihet jo vetëm në identitetin kombëtar si p.sh tek gjermanët, të ndarë në protestantë dhe katolikë, apo tek shqiptarët të ndarë në synitë, (bektashinj, ortodoksë, katolikë), por as në identitetin familjar s’e ndeshim si dikur, tek familjet laramane të Lurës, ku njëri vëlla ishte mysliman dhe tjetri katolik.

Çdo komb përfaqësohet me identitetin e vet kombëtar, i cili në thelb është një identitet kulturor dhe qytetar, me komponentë të tillë, siç janë gjuha e banorëve, trashëgimia historike, kultura popullore, mentaliteti shoqëror, mënyra e jetesës, e drejta e pashkruar.....por si?

Përmes poetit Ferrik Ferra, sjellim në kujtesë poezinë e tij me titull: “Kombi”, një poezi sa prektëse aq edhe në mbështetje të diskutimit tonë në këtë punim.

*“Kombi, mjafti që rrjedh në gjuhën e nanës,
kombi, trandafili i gjakut midis shpatës e plumbit,
kombi, mishi i gurit në shpirtin e qiellit,
kombi, besa e lidhun në rrjedhat e ditës.
Kombi, gjahu i pëlqye nga thikat e kohës,
kombi, kafshatë e ngjye në njelmin e lotit,
kombi, durim i shtye tej cakut të ferrit,
kombi, brilant i këputun në lotët e mërgimit.
Kombi, bardhësi e rrëmbyer në majat e kreshtës,
kombi, bukuri e grabitun në qiellin e vajzave,
kombi, kërthndezje e rimtë n’durimin e Prometheut.
Kombi, tjetër gur peshe mbi shpinën e Anteut,
kombi, gjithë kohnat kërkoi ku gjindej liria,
kombi, i rrallti metal që se bren përjetësia”.¹*

¹Ferra, Ferrik, poezia: “Kombi”, në librin: Lirika, Shtëpia botuese “ADA”, Tiranë, 2021, f. 94. Poezia: “Kombi” e autorit Ferrik Ferra është shkruar në Tiranë, më 12.09.2004.

Rreth çështjes së identitetit, shtetit dhe kombit shqiptar

Në vitin 2006 lindi një diskutim mjaft i ndezur dhe i zhurmshëm mbi çështjen e identitetit, shtetit dhe kombit shqiptar. Në qendër të këtij debati ishin tri prej figurave më të njohura të kulturës bashkëkohore shqiptare, akademik Rexhep Qosja, shkrimtari i ndjerë Ismail Kadare dhe historiani i njohur Kristo Frashëri.

Pra ky diskutim mes palëve ishte jo një konflikt, por një ballafaqim idesh dhe qëndrimesh ndaj çështjes së identitetit, duke argumentuar se këto diskutime mes palëve nuk tregojnë konflikt por, tregojnë se:

a) Vetë çështja e identitetit është komplekse, sepse përfshin shumë fusha, çështje, drejtime, pra është shumëdimensionale, ndaj edhe qëndrimet ndaj saj, s'ka si të jenë të njëjta, sepse këndvështrimi i studiuesve është i pozicionuar nga pikëpamje të ndryshme.

b) Diskutimi i ndezur i palëve akademike tregon qartë natyrën e vetë objektit të diskutimit, pra është jo tregues i konflikteve mes palëve akademike, por tregues i vëmendjes maksimale që ekziston prej tyre ndaj kësaj çështjeje kaq delikate, e cila provokon shumë sot e gjithë ditën. Profesor Rexhep Qosja i ka parashtruar në tri broshura të botuara njëra pas tjetrës, të tilla, si: *Ideologjia e shpërbërjes, Realiteti i shpërfillur, Të vërtetat e vonuara*.

Sipas studiuesit Idriz Ajeti, i cili ndër të tjera e njehtësonte figurën e Rexhep Qosjes: “Po të ndiqen me kujdes shkrimet, studimet e profesor Qosjes dy janë shqetësimet e tij: në një anë, janë kërkimet e studimit e historisë së letërsisë-në radhë të parë ato shqiptare, gjithëherë të shtrira e në përfaqje me të letërsive të fqinjëve dhe përtej tyre, në anë tjetër, kërkesa e tij, çdoherë e në çdo vend të zbatohet me përpikëri gjuha letrare shqipe dhe kultivimi i gjuhës së njësuar letrare (shqipe)”.²

Studiuesi Rexhep Qosja pranon se dikur identiteti kombëtar shqiptar ishte gatuar, duke patur si komponent fenë e krishterë. Ai pranon gjithashtu se feja islame u përfaqësua nga shumica e shqiptarëve gjatë shekujve të sundimit osman.

Kurse studiuesi Sadri Fetiu lidhur me figurën dhe në veçanti me veprën e studiuesit Rexhep Qosja, shkruan: “E para, vepra e Rexhep Qosjes me tërësinë e saj mbetet një porosi e madhe për ne shqiptarët e sotëm dhe për brezat e ardhshëm se si duhet të punojmë me ngulm që t'i japim kuptim të plotë jetës sonë për ta zënë vendin që na takon midis kombeve të qytetëruara të Evropës; dhe e dyta, kjo vepër, brenda shumësisë së ideve dhe idealeve njerëzore, gërsheton pikësynimin idealist të çdo krijuesi të madh, shpresën dhe besimin e plotë se populli, i cili ka vendosur të çlirohet, doemos do të arrijë një ditë në cakun e dëshiruar”.³

Libri i R. Qosjes, *Ideologjia e shpërbërjes* trajton çështje të tilla si: -

- Identiteti kombëtar dhe gjuha standarde;
- Identiteti kombëtar dhe vetëdija fetare;
- Identitetishqiptar dhe identiteti kosovar;
- Identiteti kombëtar dhe mimikria politike

Në librin *Realiteti i shpërfilluar* studiuesi R. Qosja trajton këto çështje:

- Premisa të gabuara;
- Shprehjet e vjetra;
- Përdorimi politik i ermit të Nënës Tereze;
- Identiteti dhe identitetit;
- Evropa shumë kulturore;
- Ide raciste;
- Gjeografia lëvizëse;
- Identiteti dhe kultura;

²Ajeti, Idriz, *Në gjashtëdhjetë vjetorin e lindjes së akademik Rexhep Qosja*, në: “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave filologjike, 26-1996, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 13.

³Fetiu, Sadri, *Fenomeni Rexhep Qosja në kulturën shqiptare*, në: “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave filologjike, 26-1996, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997, f. 24.

- Thirrje për kthim në fenë e të parëve;
- Cili s'është misioni i Shqipërisë;
- Ideniteti i nënçmuar;
- Si ta sjellim Evropën në jetën tonë.

Ndërsa libri *Te vërtetat e vonuara*⁴ trajton çështjet e tilla, si:

- Qëndrime kundërmyslimane;
- Esadizmi;
- Reakime ndaj polemikës;
- Ku e lamë Kosovën;
- Si po zgjidhet çështja kombëtare;
- Besimi dhe mosbesimi;
- Krahassime që s'bëhen;
- Edhe kryeparlamentarja futet në polemikë.

Konceptet kryesore që formulon R. Qosja në librat e tij, janë: Prejardhja e përbashkët, kultura, gjuha, sistemi i vlerave, historia e përbashkët, do të jenë ata faktorë themelore të identitetit kombëtar të shqiptarëve, duke i ndaluar specifikisht në çështje, si:

- Identiteti dhe gjuha standarde;
- Vetëdija fetare;
- Qytetërimi i krishterë dhe qytetërimi islamik;
- Tërësia dhe pjesët;
- Koncepti feudal dhe koncepti modern për kombin.

Pjesa më domethënëse të libri *“Të vërtetat e vonuara”* të R. Qosjes përgjigjja e tij e dytë nga, e cila dhe *dëshiroj t'ju sjell në kujtesë rastin kur autori thotë:*

“Qëllimi im është që të shpjegoj çështjet e ngritura ashtu siç duhet t'i shpjegoj njeriu që nuk pranon të zëvendësohen arsyeja me urrejtjen e argumenti me mashtrimin, domethënë qëllimi im është që të bëj një përgjigje që do të mund të ishte e dobishme për letërsinë, për histori-në e letërsisë, për kulturën dhe ndoshta, për politikën tonë”⁴.

Ky argument i R. Qosjes është i vërtetë dhe në të njëjtën linjë shprehet edhe sociologu Max Weber, i cili thoshte: *“Një kriter apo një tjetër nuk do të thotë se është i vlershëm gjithandej, asnjë kriter nuk është i vlershëm në kontekste të ndryshme, nuk ka kritere universale”*⁵.

Sipas R. Qosjes, të gjitha identitetet-individual e kolektiv, kulturor, fetar, politik etj, mund të bashkohen në një të tërë, e quajtur identiteti kombëtar, d.m.th, identiteti fetar është element, pjesë e identitetit kombëtar⁶.

Në vijim akademik Rexhep Qosja shprehet se shqiptarët janë me identitet katolik, ortodoks, mysliman; bashkohen në një të përgjithshme, identitetin kombëtar shqiptar. Shumica e shqiptarëve, siç dihet janë myslimanë, pavarësisht se jo të gjithë janë besimtarë prapë thellë në shpirtin e tyre kanë diçka nga myslimanizmi. R. Qosja flet për një identitet shqiptar, që është, sa oksidental, po aq edhe oriental.

R. Qosja e quan identitetin tonë dinamik e që nuk duhet ta fshehim “myslimanizmin” tonë real. Një nga pikëpamjet e Rexhep Qosjes ishte edhe trajtimi prej tij i çështjes fetare si përbërës i identitetit kombëtar shqiptar.

Në lidhje me këtë çështje, Rexhep Qosja, shkruan kështu: *“Kemi identitete të veçanta dhe identitete të përgjithshme, identitete vetjake dhe identitete kolektive, identitete konvencionale dhe identitete të reja, identitete historike dhe identitete kulturore, identitete politike dhe identitete mendore, identitete fetare dhe identitete shterërore etj”*⁷.

Të gjitha këto identitete që janë identitete më pak a më shumë të veçanta, të një rrafshi më të ngushtë, bashkohen në një të tërë, që do t'i themi “identitet kombëtar”. Pra këto identitete të

⁴ Qosja, Rexhep, *Të vërtetat e vonuara*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2006, f. 113.

⁵ Weber, Max, *Studime sociologjike*, Shtëpia botuese “Plejad”, Tiranë, 2004, f. 48.

⁶ Qosja, Rexhep, *Ideologjia e shpërbërjes*, Shtëpia botuese “Toena”, Tiranë, 2006, f. 24.

⁷ Rexhep Qosja, *Ideologjia e shpërbërjes*, vep. e cit., f. 67.

veçanta që kemi -shprehet Rexhep Qosja: *“Kemi shqiptar me identitet kosovar, shqiptar me identitet lab, shqiptar me identitet gegë, shqiptar me identitet toskë, shqiptar me identitet mirditor, shqiptar me identitet malësor, por të gjitha këto identitete të veçanta, bashkohen në atë “që i themi identitet kombëtar shqiptar”⁸.*

Përfundim

Në fund fare mund të themi se identiteti i një populli nuk është i caktuar njëherë e përgjithmonë, pasi identiteti i një populli është kategori historike: në procesin historik ai vjen duke u pasuruar apo edhe duke u varfëruar dhe pak a shumë duke ndryshuar. Në procesin historik identitetet e kombeve marrin dhe japin, sepse për fat të mirë marrin dhe japin kulturat e tyre, qytetërimet e tyre në takime e dialogë me kultura e qytetërimet të kombeve të tjera.

Referencat

- [1]. Ajeti, I. (1997). Në gjashtëdhjetëvjetorin e lindjes së akademik Rexhep Qosja. Në Gjurmime albanologjike: Seria e shkencave filologjike (Vol. 26, 1996). Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- [2]. Ferra, F. (2021). Kombi. Në Lirika. Tiranë: Shtëpia botuese “ADA.”
- [3]. Fetiu, S. (1997). Fenomeni Rexhep Qosja në kulturën shqiptare. Në Gjurmime albanologjike: Seria e shkencave filologjike (Vol. 26, 1996). Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës.
- [4]. Qosja, R. (2006). Ideologjia e shpërbërjes. Tiranë: Shtëpia botuese “Toena.”
- [5]. Qosja, R. (2006). Të vërtetat e vonuara. Tiranë: Shtëpia botuese “Toena.”
- [6]. Weber, M. (2004). Studime sociologjike. Tiranë: Shtëpia botuese “Plejad.”

⁸Po aty, f. 43.